

**AKT- THEMELIMI
PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË “ORTEK 2019” SH.P.K**

Neni 1

Në Tiranë, sot më datën 10.04.2019, me vullnetin tonë të lirë dhe në përputhje me ligjin nr.9901, datë 14.4.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar dhe ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, të ndryshuar, si dhe legjislacionin shqiptar në përgjithësi, shoqëria “**ORTEK 2019**” **SH.P.K.**, shoqëri e regjistruar rregullisht në Shqipëri, bazuar në vendimin e Asamblesë, vendosi të krijojë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar “**ORTEK 2019**” **SH.P.K.**

Neni 2

Shoqëria “**ORTEK 2019**” **SH.P.K** krijohet nga ortakët themelues, me ortakë **z. Jetnor SINOMATI** dhe **znj. Eurora DOÇI** dhe me administrator **znj. Eurora DOÇI**.

Neni 3

Shoqëria do të emërtohet “**ORTEK 2019**” **SH.P.K.**

Neni 4

Shoqëria “**ORTEK 2019**” **SH.P.K.** do të ketë selinë e saj në adresën: **Rruga Shkëlqim Fusha, Selitë, Tiranë, Shqipëri.**

Neni 5

Shoqëria “**ORTEK 2019**” **SH.P.K.** ka të drejtë të krijojë filiale të saj brenda dhe jashtë shtetit, në çdo kohë që do të shihet e arsyeshme prej saj me miratim të organeve kompetente.

Neni 6

Shoqëria “**ORTEK 2019**” **SH.P.K.** gëzon statusin e personit juridik. Veprimtaria e saj do të zhvillohet në bazë të Aktit të Themelimit, Statutit të saj dhe legjislacionit në fuqi në Republikës e Shqipërisë. Statuti i shoqërisë i bashkëngjitet këtij Akti Themelimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 7

Veprimtaria e shoqërisë si person juridik fillon me miratimin e kërkesës për regjistrim nga Qendra Kombëtare e Biznesit në përputhje me ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, i ndryshuar dhe do të vazhdojë për një periudhë të pacaktuar.

Shoqëria e mbyll aktivitetin e saj në çdo kohë me:

1. Me vendim të Asamblesë së Ortakëve;
2. Me vendim të gjykatës kompetente;

3. Me zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve për falimentimin.
4. Me vendim të Asamblesë së Ortakëve, vendim i cili vendos shndërrimin e shoqërisë nga Sh.P.K. në një lloj tjetër shoqërie.
5. Në rastet e tjera të parashikuara në legjislacionin në fuqi të RSH.

Neni 8

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë “ORTEK 2019” SH.P.K., do të jetë:

“Veprimtaria financiare e këmbimeve valutore, ushtrim i veprimtarisë së transferimit të parave në emër dhe për llogari të subjektit financiar jo-bankë Ak-IVEST sha.a”

Shoqëria është pronare, përdoruese dhe disponuese e pasurive të saj në përputhje me qëllimin dhe objektin e veprimtarisë së saj.

Shoqëria mund të blejë dhe të shfrytëzoj të drejta materiale, përfshirë të drejtën për të ofruar pasurinë e saj personave të tjerë dhe për të marrë kredi nga institucionet përkatëse financiare.

Neni 9

Administrator i Shoqërisë “ORTEK 2019” SH.P.K. është **znj. Eurora DOÇI**.

Neni 10

Kapitali fillestarë i shoqërisë është në vlerën 1.500.000 (një milion e pesëqind mijë) lekë.

Neni 11

Fitimi neto që do të realizohet nga veprimtaria e kësaj shoqërie i takon 60% të kapitalit të shoqërisë ortakut z. Jetnor SINOMATI dhe 40% të kapitalit të shoqërisë ortakut znj. Eurora DOÇI.

Neni 12

Për detyrimet që do të krijohen ndaj personave të tretë, gjatë aktivitetit të kësaj shoqërie do të përgjigjet vetëm me kapitalin e saj. Ortakët e shoqërisë nuk mbajnë përgjegjësi për detyrimet e kësaj shoqërie me pasuritë e tyre që nuk bën pjesë në kapitalin e kësaj shoqërie.

Neni 13

Nuk mund të pranohet në këtë shoqëri, si ortak asnjë person tjetër pa miratimin e Asamblesë së Ortakëve.

Vetëm me vendim të Asamblesë e Ortakëve të Shoqërisë, pjesë të kapitalit të shoqërisë mund t’ju shiten personave të tjerë që nuk bëjnë pjesë në këtë shoqëri, gjithmonë me akt të shkruar dhe të vërtetuar nga organet përkatëse publike sipas legjislacionit në fuqi dhe në përputhje me dispozitat e statutit të shoqërisë.

Neni 14

Marrëdhëniet e punës në shoqëri ose në filialet e saj do të rregullohen në bazë të kontratave të punës dhe legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 15

Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis shoqërisë me persona të tjerë do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt organi kompetent për zgjidhjen e tyre, do të jetë Gjykata Rrethit Gjyqësor Tiranë, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Neni 16

Ky Akt-Themelimi, pasi u lexua nga ortakët themelues dhe u gjet në përputhje të plotë me vullnetin e tyre, nënshkruhet rregullisht nga ortakët themelues të kësaj shoqërie.

Tiranë, më 10.04.2019

ORTAKËT THEMELUES

“ORTEK 2019” SH.P.K.

z. Jetnor SINOMATI



znj. Eurora DOÇI

